



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 06/2025

I Mbajtur në takimin e VI-të të rregullt të KPF-së me datën 27.06.2025, në sallën e takimeve në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VI-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së.
2. Miratimi i rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së.
4. Propozim-Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028.
5. Propozim-Vendim për shpalljen interes i përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale: 555-0 Z.K.Balaj, pronë private.
6. Pyetje dhe kërkesa.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se i kemi edhe dy pika shtesë që janë anulime të vendimeve, me numër 31 dhe 32 të datës 28.03.2025 me të cilat e kemi shkarku nënkryetarin e komunës z.Danush Ademi dhe e kemi emëru tjetrin z.Qazim Rahmani, mirëpo ministria pas vlerësimit të ligjshmërisë ka konstatu se të njëjtat janë në kundërshtim të plotë, pasi që nuk janë respektuar procedurat ligjore dhe si të tilla duhet t'i anulojmë, dhe një pikë për aksionaret e komunës në ndërmarrje publike që t'i bëhet paga sa minimalja e pagës në nivel vendi të parashikuar me ligj,

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës me pikat shtesë dhe kaloi me 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Sa i përket procesverbalit të KPF-së, a keni ndonjë vërejtje, pasi nuk pat të interesuar për diskutim kryesuesi e hodhi në votim dhe kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 4-të që ka të bëjë me KAB, dhe pasi spati të interesuar për të diskutuar kaloi për në kuvend me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 5-të dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Sabri Murseli i cili theksoi se në këtë vend ka fillu varrimi që sa kohë, mirëpo nuk kemi pas një dokument vendim të kuvendit, s'kemi gjetë asgjë, andaj pronari ka kërku zhvarrosje dhe kemi vendos me ba shpronësim dhe më pas të shikohet si të kompensohet, Kryesuesi e hodhi në votim dhe kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi theksoi se pika 6-të ka të bëjë me anulimin e vendimit 31 dhe 32 të datës 28.03.2025 dhe spati të interesuar për diskutim kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Propozim vendim për pezullimin e vendimit me Nr. 26 i datës 28.03.2025 Sabri Murseli mbasi ministria ka kërku që të anulohet, ne duhet t'i pezullojmë për shkak se s'kemi drejt t'i procedojmë për shkak që janë shpallur zgjedhjet, kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Sabri Murseli e paraqiti edhe pikën tjetër që është propozim vendim për pezullimin e Vendimit 01.Nr 39 të datës 30.04.2025, përmes së cilës është dhënë pëlqim "Ambientit" duhet të pezullohet pasi ka ardhë shkresa nga ministria në Muajin e 5-të, pasi s'diskutoj askush u hodh në votim kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.


Propozim vendim për pezullimin e vendimit të cilin e kemi marrë për memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe OJQ-ve "Shtëpia ime" me Nr. 38 i datës 30.04.2025.

Kjo pikë kaloi me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e theksoi se e kemi edhe një pikë për nivelizimin e pagës për aksionar që ka të bëjë me pagën minimale ku duhet të nivelizohet, pasi nuk diskutuan në KPF e votuan për ta dërguar në kuvend me 7 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.


Kryesuesi pyeti nëse në të ndryshme ka dikush diçka, pasi s'pati Kryesuesi i mbylli punimet e kësaj mbledhje.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

